

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rritja e çmimit të naftës në 229 lekë litri, Braçe: Edhe Kosova furnizohet nga të njëjtët shitës që na shesi n edhe ne, por nuk e ka rritur çmimin
ADRESA	https://www.gazetatema.net/ekonomia/rritja-e-cmimit-te-naftes-ne-299-leke-litri-brace-ed-he-kosova-furnizohe-i585863
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 16:52:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 16:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ee2780aa71844dd9f0d4228ab14214495c3a72b8c724ae929f8e2993993da04b
TEKSTI	06e7ec3a80ba7bd77496e3c6d61d94a434fe3125ac335d9c63354953c338c7db
PAMJA	59b8d98203ef8197a036c3c93f9e25d3f786c9d5f7d2199df6d13a1bf638f2a0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2b35900d83e88fd4661987db4274bddd39addf0977dd9d3c0853766ef1e04128
E MËPARSHMJA	87ed30cf2f31f7eaf52f39e9e11443e887765eb99c83443cc0c9c983a00c3a58
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2b35900d83e88fd4661987db4274bddd39addf0977dd9d3c0853766ef1e04128>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e Një person tutet ne shtepine e Kamala Harris ne Kaliforni, nderhyn personeli i sigurisePuc institucional i "Republikes se Magjistrave"Çgryqji i ish kreteve te UÇK/ Ministri i Drejtësisë së RMV: fundit

Rritja e çmimit të naftës në 229 lekë litri, Braçe: Edhe Kosova furnizohet nga të njëjtët shitës që na shesin edhe ne, por nuk e ka rritur çmimin

13 Shtator 2026, 18:50Ekonomia TEMA



Rritja e çmimit të naftës në 229 lekë litri,

Deputeti socialist Erion Braçe ka reaguar për rritjen e çmimit të naftës, duke ngritur pikëpyetje mbi mënyrën se si funksionon tregu i karburanteve dhe strukturën e taksave e tarifave që përfshihen në çmimin final.

Braçe thekson se çmimi i naftës ka arritur në 229 lekë për litër, duke u rritur me 10 lekë që nga dita e djeshme, ndërkohë që vendet fqinje nuk kanë marrë një hap të tillë.

“Nafta 229 lekë, nuk është thjesht një produkt dhe një çmim. Është rritur që dje me 10 lekë! Cent më cent, është 2.48 euro! Fakt është që secili nga vendet kufitare me ne nuk e ka ndryshuar çmimin as dje, as sot: Mali i Zi ka një çmim prej 1.87 euro, Kosova ka një çmim prej 1.76–1.85 euro, Maqedonia ka një çmim prej 1.64 euro.

Po e përsëris, këto janë çmime që nuk janë ndryshuar dje, as sot! Patjetër që do të pyes: Çfarë po ndodh? Për më tepër që Kosova furnizohet nga të njëjtët shitës që na shesin edhe ne”, shprehet Braçe.

Braçe u drejton dy kërkesa aktorëve që monitorojnë tregun, garantojnë konkurrencën dhe përcaktojnë politikën fiskale. Së pari, ai kërkon që të analizohet modeli i tregut të karburanteve, duke ngritur shqetësimin për përqendrimin e furnizimit dhe aktivitetit tregtar në pak operatorë. Së dyti, deputeti kërkon rishikimin e strukturës së taksave dhe tarifave që përfshihen në çmimin e naftës.

“Dy gjëra dua të them dhe po ia them çdo aktori që monitoron tregun, garanton konkurrencën e lirë dhe bën politikën fiskale: E para, një herë të vetme duhet të merreni seriozisht me modelin e tregut. Kemi përfunduar të kemi vetëm një furnizues-shitës nga i cili nis çmimi, British Petroleum, i shtrenjtë; kemi përfunduar të kemi vetëm një port; kemi vetëm një marrëveshje, deri tani të panjohur, veçanërisht për të parë se si ndahet përfitimi nga blerjet në avancë dhe risku po prej tyre; kemi dy aktivitete: i pari, i depozitimit dhe shitjes ditore në kompanitë shqiptare, dhe i dyti, anije më anije në det, në territorin shqiptar (përsëri marrëveshje e panjohur dhe ndarja e përfitimeve përsëri e tillë); pra, në të gjithë operacionin tregtar kemi vetëm një-dy operatorë!

E dyta, është momenti për të parë strukturën e taksave dhe tarifave të futura brenda çmimit të naftës, duke filluar nga ato që nuk kanë lidhje me çmimin, por me taksa e tarifa për të cilat shteti ka institucione që paguhen shtrenjtë; duke nisur nga taksa e qarkullimit, për të vijuar me tarifa shërbimesh pa asnjë lidhje me çmimin. Duhet bërë tani! Duhet të jesh pa sy e mendje për të mos parë e kuptuar që vetëm nga eliminimi i tregtisë dhe kontrabandës me fqinjët, do të fitohet shumë më tepër se sa nga ky çmim”, përfundon Braçe.

2 Komente



Patronazhisteve cekic ballit

13 Shtator 2026, 18:53

Fajin e ka Saliu.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Labeati

13 Shtator 2026, 18:59

1.Te shtohen operator. 2..Te hiqet taksa e qarkullimi 270 leke l dhe te paguhet vec sic e paguajne ne Mal te Zi 800 euro ne vit si ai qe e perdore nje here ne jave makinën si ai qe e perdore 24 ore

← Përgjigjuni

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0

🗨️ Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Shtrenjtimi i naftës mbush arkën e shtetit, 18 mln euro më shumë në vetëm pesë muaj](#)

14:10 Ekonomia / 4 komente

[Banesat pa pronar - Avokati: Në emër të kujt bëhet legalizimi? Hiqen pengesat e gjykatave](#)

17:30 Ekonomia / 4 komente

[OTP Bank Albania zgjeron rrjetin e degëve në Tiranë me hapjen e një dege moderne në Rugën e Kosovarëve](#)

16:19 Ekonomia

[Shqipëria marrëveshje të reja me Gjermaninë, Karakaçi: 110 milionë euro investime në konvikte, Vaun e Dejës dhe digjitalizimin e nënstacioneve elektrike](#)

14:00 Ekonomia / 6 komente

[FMN qendër për integrimin e shteteve ballkanike](#)

13:10 Ekonomia / 1 koment

[Furnizimi me gaz/ Shqipëria nënshkruan marrëveshje me kompaninë amerikane, pritet ndërtimi në bregdet i një terminali me kapacitet deri në 5 milionë tonë në vit](#)

21:25 Ekonomia / 10 komente

[Ministri Salla nga Shkolla Profesionale Bujqësore e Golemit: Të rinjtë të zgjedhin arsimin profesional dhe bujqësinë](#)

20:48 Ekonomia

[Raporti/ Turistët shpenzuan në Shqipëri 2.3 miliardë euro në gjysmën e parë të vitit!](#)

20:15 Ekonomia / 1 koment

[Sejko, takim me BERZH - Fokus te kreditimi, bizneset e vogla dhe integrimi në BE](#)

14:25 Ekonomia

[Banesat pa certifikatë pronësie - Kadastra, “derë më derë”. Si do kryhet procesi i verifikimit?](#)

13:55 Ekonomia / 5 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Vuçiq ndryshon ‘pllakë’ për Thaçin: Në Paris mora “sinjal...](#)

22:00 Rajoni / 10 komente

[Shënime nga Konventa e Teksasit në ShBA](#)

12:00 Blog / 50 komente

[Çfarë fshihet pas teorisë së Prokurorisë? Eksperti amerik...](#)

13:00 Rajoni / 3 komente

[Diskutimet për bashkimin e Vlorës me Selenicën, Rama rea...](#)

22:20 Politika / 19 komente

[Ngërçi me pagat e magjistratëve, Rama publikon tabelën: G...](#)

09:50 Politika / 52 komente

Blog Tema

[Puç institucional i ‘Republikës së Magjistratëve’?](#)

19:10 Blog

[Ju nuk na përfaqësoni!](#)

18:00 Blog

[Kur pushteti politik abdikon ndaj atij gjyqësor](#)

16:13 Blog / 10 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)

- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.